

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Për të përmbushur misionin e vet në ngritjen e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, aktualisht ofron 24 module, bazuar në tri (3) Standardet e Profesionit, që janë të aprovuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve:

1. Bashkëpunëtorë profesional të punës sociale, dymbëdhjetë (12) module;
2. Profesionistë të punës sociale dhe të këshillimit, njëzetë (20) module;
3. Menaxher i mirëqenies sociale, nëntë (9) module.

1. Programet e Trajnimit për Bashkëpunëtorë Profesional të Punës Sociale

1.1. Bashkëpunëtorë Profesional të Punës Sociale

Në këtë program të trajnimit përfshihen bashkëpunëtorët profesional të punës sociale, të cilët karakterizohen me ofrimin e shërbimeve të personave dhe kategorive të ndryshme në nevojë. Ai/ajo ofron përkujdesje për shëndetin e klientit duke filluar me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të klientit, përgatitjen e planit të veprimit rreth nevojave të tij/saj si dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura sipas nevojave të klientit. Përpos kujdesit shëndetësor, ai/ajo përkujdeset për nevojat ditore të klientit.

Këto aktivitete i realizon duke ofruar përkujdesje klientit në gatimin e ushqimit, ofrimin e përkujdesjes së klientit në mirëmbajtjen e higjienës dhe mirëmbajtjes së shtëpisë si dhe në blerjen e produkteve për klientin.

Për klientin e tij/saj përkujdeset rreth shërbimeve të transportit dhe lëvizshmërisë. Atë e bën duke ofruar mbështetje në lëvizshmëri të klientit nëpërmjet transportit me makinë dhe me karrocë për personat me apo pa aftësi të kufizuara. Poashtu përkujdeset për higjienën e klientit dhe ambientit që e rrethon. Ai/ajo angazhohet me ofrimin e përkujdesje për higjienë personale të klientit, kujdesin e ofruar për veshjen apo zhveshjen e kandidatit si dhe përkujdesin e ofruar rreth nevojave shqisore të klientit. Ndërsa sa i përket aktiviteteve sociale të klientit, ai/ajo organizon dhe menaxhon aktivitetet sociale për ata. Zakonisht e bënë duke organizuar aktivitete dhe lidhje shoqërore me klientin si dhe përgatitjen dhe bashkërendimin e aktiviteteve për grupe individësh.

Këta bashkëpunëtorë profesional mund të punojnë, sikurse në shtëpi të pleqve, qendra të ndryshme rehabilitimi, shtëpi private të klientit si dhe në institucione të tjera relevante dhe publike

Programi i trajnimit për Bashkëpunëtor Profesional të Punës Sociale është i zhvilluar për nivelin 4 të KKK, ka gjithësej 12 module apo 460 orë që janë të barabarta me 23 ECVET:

1. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
2. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
3. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
4. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e fëmijëve (0-18);
5. Standardet minimale të shërbimeve sociale për persona madhor dhe të moshuar;
6. Puna me persona me aftësi të kufizuara;
7. Puna me viktimat të krimeve seksuale dhe trafikimit;
8. Puna me përdorues të substancave psiko-aktive;

9. Puna me familjen, grupet e cënueshme dhe komunitetin;
10. Puna me viktimat e dhunës në familje, trajtimi dhe referimi;
11. Shërbime psiko-sociale dhe shkathtësi këshillimi;
12. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara

2. Programi i Trajnimit për Profesionistë e Punës Sociale dhe të Këshillimit

2.1. Profesionist i Punës Sociale dhe të Këshillimit

Në këtë program të trajnimit është paraparë të përfshihen profesionistët e punës sociale dhe të këshillimit që merren me menaxhimin dhe trajtimin e individit, familjes dhe grupeve të cënueshme të shoqërisë në nevojë për mbrojtje sociale, të cilët ndërhyrjen profesionale në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve e mbështesin mbi ligjet e aplikueshme në fushën e shërbimeve sociale, Konventat, kodin etik dhe standardet minimale të shërbimeve sociale dhe familjare si dhe të arriturave më të reja nga shkencat sociale. Në praktikën e punës sociale të trajnimit dhe menaxhimit të rastit ata udhëhiqen nga interesi më i mirë i klientit ku së bashku me 11 klientët e shërbimit përpunojnë planin individual të shërbimit, ndajnë përgjegjësitë e zbatimit, dakordohen për dinamikën e zbatimit të planit si dhe për partnerët e tjerë relevant të cilët do të inkuadrohen në realizimin e planit.

Profesionistët e punës sociale dhe të këshillimit gjatë trajnimit të rastit aplikojnë forma të posaçme të mbrojtjes sociale të përcaktuara me Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës siç janë: Bashkimi Familjar, Strehimi Familjar, Kujdestaria, Adoptimi dhe Strehimi rezidencial dhe sipas nevojës edhe shërbime materiale. Këto forma të mbrojtjes dhe shërbime ju ofrohen kategorive të caktuara të popullatës të specifikuar bazuar në Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare duke siguruar qasjen e tyre në shërbime të domosdoshme dhe të përshtatshme për përmbushjen e nevojave thelbësore të klientëve siç janë: 1) fëmijët pa përkujdesje prindërore 2. Fëmijët me sjellje asociale 3. delikuentet e mitur 4. marrëdhëniet e çrregulluara në familje 5. të moshës së shtyer 6. të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike 7. të aftësive të kufizuara mendore 8. të sëmundjes mendore 9. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzim të dhunës në familje 11. të trafikut të qenieve njerëzore 12. të varësisë nga alkooli ose drogat 13. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu 14. ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

Përgatitja profesionale: Profesionisti i punës sociale dhe të këshillimit nënkupton një profesionist të shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmë tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në regjistër të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.

Fushat e zbatimit të punës sociale për këtë kategori janë: 1. Institucionet e mirëqenies sociale, 2. Në sistemin edukativo-arsimor, 3. Institucionet e drejtësisë, 4. Shëndetësisë, 5. Në organizata jo qeveritare ofruese të shërbimeve sociale dhe familjare, 6. Në institucionet religjioze, 7. Në industri.

Programi i trajnimit për Profesionistë të Punës Sociale është i zhvilluar për nivelin 4 të KKK, ka gjithësej 20 module, apo 780 orë të barabarta me 39 ECVET:

1. Puna sociale dhe profesioni i punëtorit social

2. Politikat sociale dhe programet e mbrojtjes sociale;
3. Legjislacioni i shërbimeve sociale;
4. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
5. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
6. Menaxhimi i rastit, vlerësimi i nevojave dhe hartimi i planit individual për klientë;
7. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
8. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e fëmijëve (0-18);
9. Standardet minimale të shërbimeve sociale për persona madhor dhe të moshuar;
10. Puna me persona me aftësi të kufizuara;
11. Puna me fëmijë në punë të rënda dhe të rrezikshme;
12. Puna me viktime të krimeve seksuale dhe trafikimit;
13. Puna me përdorues të substancave psiko-aktive;
14. Puna me migrantë, refugjatë, të rikthyer dhe të riatdhesuar;
15. Puna me familjen, grupet e cënueshme dhe komunitetin;
16. Puna me viktimat e dhunës në familje, trajtimi dhe referimi;
17. Shërbime psiko-sociale dhe shkathtësi këshillimi;
18. Shëndeti mendor, trajtimi dhe referimi;
19. Psikologjia e zhvillimit;
20. Standardet minimale të shërbimeve sociale për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

3. Programi i Trajnimit për Menaxher të Mirëqenies Sociale

3.1. Menaxher i mirëqenies sociale

Në këtë program të trajnimit do të përfshihen menaxherët e mirëqenies sociale, të cilët amenaxhojnë stafin e ofruesve qeveritar dhe jo qeveritar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Bëjnë menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit vartës të ofruesve qeveritar dhe joqeveritar përfshirë vlerësimin e nevojave të tyre për zhvillim të mëtutjeshëm, formimin dhe menaxhimin e grupeve të ndryshme profesionale si dhe përmbushjen e nevojave të komunitetit. Poashtu planifikojnë dhe menaxhojnë shërbimet sociale dhe familjare. Këto planifikime i realizojnë duke zbatuar politikat dhe strategjitë sociale dhe familjare nga ana e menaxherit, bërjen e planifikimeve strategjike dhe ekzekutimin e tyre, zbatimin e aktiviteteve dhe përgjegjësi të menaxheriale, si dhe menaxhimin e shërbimeve sociale të nivelit qendror. Këta profesionistë menaxhojnë buxhetin dhe llogaritjen e kostove financiare për shërbime sociale dhe familjare duke menaxhuar buxhetin për shërbimet sociale, përgatitjen e kostove për zbatimin e programeve dhe projekteve për shërbime sociale, menaxhimin financiar, raportimin dhe kontrollimin e shpenzimeve të buxhetit për shërbime sociale dhe familjare.

Pjesë e punës së menaxherit të organizatave për punë sociale është menaxhimi dhe monitorimi i shërbimeve sociale dhe familjare të kontraktuara nga sektori publik. Ajo ka të bëjë me aktivitetet e menaxherit të Ofruesit Qeveritar dhe Joqeveritar të shërbimeve sociale dhe familjare në bërjen e planifikimeve bazuar në nevoja dhe zhvillimit të tregut të shërbimeve sociale, monitorimin e shërbimeve të blera nga OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, si dhe menaxhimin dhe vlerësimin e kontratave për shërbimet sociale. Ai/a jo poashtu monitoron, dhe mundëson inspektimin dhe vlerësimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Ky funksion ka të bëjë me krijimin e kushteve për monitorim dhe inspektim e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.

Janë të shumta vendet që këta bashkëpunëtorë profesional mund të punojnë, sikurse në shtëpi të pleqëve, qendra të ndryshme rehabilitimi, shtëpi private të klientit si dhe në institucione të tjera relevante dhe publike (bazuar në përshkrimin e standardit të profesionit, shih dokumentin).

Programi i trajnimit për Menaxher të Mirëqenies Sociale është i zhvilluar për nivelin 4 të KKK, ka gjithësej 9 module apo 340 orë që janë të barabarta me 17 ECVET:

1. Politikat sociale dhe programet e mbrojtjes sociale;
2. Legjislacioni i shërbimeve sociale;
3. Planifikimi, administrimi dhe financimi i shërbimeve sociale;
4. Monitorimi dhe inspektimi i shërbimeve sociale dhe familjare;
5. Menaxhimi dhe lidhësi në fushën e mirëqenies sociale;
6. Etika profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale;
7. Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale;
8. Standardet e shërbimeve sociale dhe familjare;
9. Parimet e mbikqyrjes/ supervizionit.